



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received / Delivery	24.08	2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojc Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
KPMESHCK	5808	2023	1/5	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.958/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë dhe Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.958/2023 të datës 13.07.2023 të parashtruar nga ankuesi Gëzim Zeqiri, nga Kamenica, kundër organit të punësimit/Komuna e Kamenicës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet** si e pabazuar ankesa me numër A.nr.958/2023 e datës 13.07.2023 e parashtruara nga ankuesi Gëzim Zeqiri.
- II. Mbetet në fuqi** Njoftimi i datës 11.07.2023 për Rezultatet Përfundimtare të Vlerësimit, i nxjerrë nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Kamenicës.

A r s y e t i m

Ankuesi Gëzim Zeqiri, i cili sipas shkresave të lëndës është kandidat në procedurën e rekrutimit për pozitën "Zyrtar i Lartë për Arsim" në Drejtorisë Komunale të Arsimit të shpallur nga Komuna e Kamenicës, me datë 13.07.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar dhe protokolluar me numër 5188/2023, kundër Njoftimit për rezultatet përfundimtare të vlerësimit të Komunës së Kamenicës të datës 11.07.2023.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshilli pretendon se Komisioni i Pranimit ka lënë sallën ku është mbajtur testi pa mbikëqyrje për rreth 15 minuta, pastaj ka pretenduar se kandidati tjetër gjatë mbarëvajtjes së testit ka biseduar me anëtarët e komisionit dhe se përmbajtja e testit me shkrime me 8 pyetje të pakuptimta ku kërkohen numrat e udhëzimeve administrative dhe ligjeve të ndryshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMESHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me

datën 19.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese te Komuna e Kamenicës. Ndërsa me datë 26.07.2023, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5188/2023/2023 të datës 13.07.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i Komisionit të Pranimit me numër 22519 i datës 11.07.2023; Ankesa e parashtruar në Komunën e Kamenicës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 19.07.2023; Përgjigja në ankesë e datës 26.07.2023; Vendimi me numër 14672 i datës 11.05.2022; Konkursi i datës 26.04.2023; Akt emërimi me numër 439/15 i datës 15.09.2011; Rënditja përfundimtare e kandidatëve; Njoftimi për rezultatet përfundimtare të vlerësimit i datës 11.07.2023; Vendim me numër 19593 i datës 5.06.2023; Akt emërim me numër 22405 i datës 19.07.2022; Rezultatet e vlerësimit për G.Z; Rezultatet e vlerësimit për R.G; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit me numër 2181 i datës 23.01.2015; Akt emërim me numër 1935 i datës 16.05.2012; Certifikata mbi dënimet penale për V.Q e datës 23.12.2022; Certifikatë e lëshuar nga European Managment Institute për V.Q; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës për V.Q me numër 175 e datës 20.0.2012; Kontratë pune me nr.ref.3/544 e datës 04.12.2012; Kopja e letërnjoftimit për V.Q; Referencë për studime doktorate e datës dhjetor 2017; Pasqyra e llogarisë në trust për V.Q; Vendim i lëshuar nga Komuna e Kamenicës me numër 18355 e datës 02.06.2023; Kërkesa për punësim e S.S e datës 22.05.2023; Certifikatë pjesëmarrje e lëshuar nga Ballkan Youth Public për S.S; Certifikatë e lëshuar nga QAPA dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për S.S- Korrik 2019; Licencë e mësimeve të lëshuar për S.S e datës 16.07.2021; Letër reference për S.S e datës 12.04.2022; Certifikatë mbi dënimet penale për S.S e datës 12.05.2023; Vendim i Komunës së Kamenicës me numër 18358 e datës 02.06.2023; Vërtetim i lëshuar nga SHMT "Andrea Durrsaku" për S.S e datës 18.01.2005; Vërtetim i lëshuar nga Shkolla FMU "Metush Krasniqi" me numër 52/19 e datës 04.07.2019; Vërtetim mbi dënimet penale e lëshuar për N.M e datës 8.05.2023; Certifikatë e lëshuar nga OJQ Dardanapress e datës 11.11.2022; Diplomë e shkollës së mesme e datës 25.06.2013; Diplomë e lëshuar nga Universitet "Hasan Prishtina" për N.M me numër 4536 e datës 20.0.02.2019; letër rekomandimi e lëshuar nga Fabrika e Bllokave e datës 14.12.2022; Kopja e letërnjoftimit për N.M; Letër rekomandimi e lëshuar nga Advors Agency; Letër reference e lëshuar nga Kopshti Poena e datës 07.10.2022; Vendim i lëshuar nga Kolegji AAB me nr.ref. MA-0348/2022 e datës 08.02.2022; Vendim i lëshuar nga Komuna e Kamenicës me numër 18356 e datës 02.06.2023; Certifikatë mbi dënimet penale e lëshuar për R.G e datës 22.05.2023; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit shkencës dhe Teknologjisë dhe Smartbits; Certifikatë e lëshuar nga ECDL Foundation për R.G e datës 23.07.2010; Vërtetim i lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe KEC për R.G e datës 01.06.2017; Certifikatë e lëshuar nga British Council dhe UK Government për R.G; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe projektit TTCB; Certifikatë e lëshuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore e Lindore për R.G e datës 18.09.2010; Certifikatë e lëshuar nga KEC dhe FIT për R.G; Certifikatë e lëshuar nga KEC për R.G me numër 29857/002 e datës 20.10.2017; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Smartbites për R.G-tetor 2020; Certifikatë e lëshuar nga USAID, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe fhi360; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për R.G; Diplomë e lëshuar për R.G me numër prot.152/1990; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës për R.G me numër 1369 e datës 04.01.2012; Kopje e letërnjoftimit për R.G; Fletë regjistrim me numër 0012197 e datës 09.07.2010; Vërtetim i lëshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit për R.G me numër 175/2023 e datës 23.05.2023; Vërtetim i lëshuar nga

SHMLP "Andrea Durrsaku" për R.G me numër 645 e datës 30.06.2015; Vërtetim i lëshuar nga Zyra e Kryetarit të Komunës së Kamenicës me numër 14255 e datës 06.06.2022; Vërtetim i lëshuar nga Shkolla fillore "Skënderbeu" për R.G me numër 109 i datës 07.12.2011; Vërtetim i lëshuar nga KEC për R.G e datës 29.09.2017; Certifikatë e lëshuar nga Corporate Finance Institute për G.Z e datës 05.07.2020; Certifikatë e lëshuar nga Cisco Networking Avcademy për G.Z e datës 14.11.2007; Certifikatë e lëshuar Courdera për G.Z; Certifikatë e lëshuar Vocup për G.Z e datës 26.11.2021; Certifikatë e lëshuar Coursera për G.Z; Certifikatë mbi dënimet penale për G.Z e datës 19.05.2023; Certifikatë e lëshuar Coursera për G.Z e datës 15.08.2020; Certifikatë e lëshuar nga Great Learning për G.Z; Certifikatë e lëshuar Meta për G.Z e datës 23.04.2023; Certifikatë e lëshuar Coursera Project netëork për G.Z e datës 07.04.2023; Certifikatë e lëshuar Coursera Project netëork për G.Z e datës 05.04.2023; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti i Kolombisë për G.Z e datës 14.04.2023; Certifikatë e lëshuar nga UCI për G.Z e datës 09.12.2021; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti i Arizonës për G.Z e datës 12.02.2023; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti i Miqiganit për G.Z e datës 26.04.2023; Certifikatë punësimi e lëshuar nga KEC për G.Z e datës 03.05.2023; Certifikatë e lëshuar nga Coursera për G.Z e datës 15.08.2020; Certifikatë e lëshuar nga Coursera për G.Z e datës 08.04.2023; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës për G.Z me numër 643 e datës 28.08.2008; Diplomë e lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina" për G.Z me numër 353 e datës 01.07.2013; Kopje e letërnjoftimit të G.Z; Letër rekomandimi për G.Z e datës 03.05.2023; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Syracuse për G.Z (shqip dhe anglisht); Vendim i lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për G.Z me nr.ref.6-1111 e datës 23.01.2018; Vërtetim i lëshuar nga Shkolla fillore Banja e Sjarinës me numër 01-19/14 e datës 22.10.2014; Letër rekomandimi i lëshuar nga Asociacioni Humanistik dhe Kulturor "Formumi Medvegja" i datës 10.10.2014; Letër rekomandimi e lëshuar SHKOLLA Fillore e Mesme e ulët "Pandeli Sotii" e datës 25.01.2010; Pasqyra e llogarisë në trust për G.Z; Vërtetim i lëshuar nga Shkolla Fillore e mesme e ulët "Dr. Ibrahim Rugova" me numër 5882/01 i datës 07.10.2014; Vërtetim i lëshuar nga Shkolla Fillore dhe Mesme Zenit për G.Z me numër prot.104/2014 e datës 20.10.2014; Letër reference e lëshuar nga American School of Kosova e datës 07.10.2014; Pliko me numër R 5420444.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka analizuar dispozitat e ligjit material, konstatoi se ankesa e ankuesit Gëzim Zeqiri, është e **pabazuar**, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga provat e lëndës ka gjetur se Komuna e Kamenicës me datë 26.04.2023 ka shpallur konkursin e jashtëm-pranim me Nr. Reference RN00011533 për grupin Specialistë i Arsimit për pozitën "*Zyrtar i Lartë për Arsim*" në kuadër të Drejtorisë Komunale të Arsimit, ndërsa si kërkesa të përgjithshme formale janë paraparë: "*Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve: Mësimdhënie apo një degë e caktuar e shkencës përkatëse dhe eksperiencë në mësimdhënie, Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*"

Nga shqyrtimi i pretendimeve ankimore që ndërliidhen me këtë pozitë, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi ka qenë kandidatë në këtë procedurë dhe në bazë të provave të lëndës është përfshirë në listën e verifikimit paraprak, dhe është ftuar të marr pjesë në testimin me shkrim ku pas kësaj faze ka marr gjithsej 55 pikë në testin me shkrim, ndërsa pas kësaj faze është bërë vlerësimi i jetëshkrimit kur rezultoi se sipas formularit të vlerësimit të jetëshkrimit ankuesi është vlerësuar me shtatëmbëdhjetë pikë (17) pikë. Sa i përket vlerësimit të intervistës ankuesi është vlerësuar me

gjashtë pikë dy (6.2) pikë, ashtu që në total nga komisioni i pranimit ankuesi ka arritur të marrë gjithsej shtatëdhjetë e tetë pikë dy (78.2) pikë duke u renditur si kandidatë i dytë në listën e renditjes përfundimtare, ku sipas Njoftimit për rezultatet përfundimtare të vlerësimit të Komunës së Kamenicës të datës 11.07.2023, ankuesi nuk rezultoi të jetë kandidat i përzgjedhur, ngase kandidati tjetër ka arritur të grumbulloi më shumë pikë, respektivisht sipas Formularit të renditjes përfundimtare kandidati R.G ka arritur gjithsejtë tetëdhjetë e tetë pikë tetë (88.2) pikë.

Sa i përket pretendimit të ankuesit lidhur me pyetjet e testit me shkrim, Kolegji i Këshillit ka vlerësuar se mbarëvajtja e testimit organizohet në mënyrë elektronike nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në kudër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ashtu që pyetjet janë përpiluar nga konform Rregullores (QRK) 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të njëjtat konsistojnë në vlerësimin e njohurive të thella dhe të specializuara në fushën profesionale specifike, pasi që kandidatët janë vlerësuar për njohuritë mbi sistemin legjislativ dhe të aplikueshëm që rregullon fushën e arsimit të cilat janë bazë mbi të cilat merren të gjitha aktivitetet e DKA si dhe aftësitë dhe cilësitë për të bërë gjykime profesionale të pavarura në mënyrë të dhënies së kontributit në zhvillimin dhe zbatimin e politikave. Sa i përket pretendimeve ankimore të ankuesit se salla ku është mbarë mbajtur testimi nuk ka qenë në mbikëqyrje për disa minuta dhe se kandidati ka biseduar me njërin prej anëtarëve të komisionit, Kolegji i Këshillit vlerësoi se të njëjtat nuk kanë qenë të mbështetura me prova materiale nga ankuesi dhe si të tilla nuk ka mundur ti vërtetoj.

Duke ju referuar Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht me nenin 25 paragrafi 2 ndërlidhur me nenin 26 paragrafi 1 të kësaj rregullore përcaktohet se: "25.2. Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues. Njësia Përgjegjëse publikon listën e kandidatëve fitues në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje; 26.1 Kandidati fitues, sipas renditjes, duke filluar nga ai me më shumë pikë, njoftohet nga njësia përgjegjëse për pozitën e lira dhe ka të drejtën të përzgjedhë çdo pozitë të lirë të Grupit dhe të emërohet në të, për të cilin është zhvilluar procedura e pranimit, si dhe në çdo pozitë tjetër të lirë të të njëjtit Grup, që krijohet e lirë deri në një (1) vit nga shpallja publike e listës të kandidatëve fitues", andaj Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi në procedurën e rekrutimit për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Arsim" në kuadër të Drejtorisë Komunale të Arsimit të Komunës së Kamenicës është vlerësuar gjithsejtë me shtatëdhjetë e tetë pikë dy (78.2) pikë, të cilat kanë qenë të pamjaftueshme për tu emëruar si kandidatë i përzgjedhur pasi kandidati tjetër ka rezultuar të grumbulloi më shumë pikë, ashtu siç përcaktohet edhe me dispozitën e lartcekura të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ngase përparësi ka kandidati i cili ka dal në listë i pari e që në rrethanat e rastit konkret kandidati R.G ka rezultuar të grumbulloi gjithsejtë tetëdhjetë e tetë pikë tetë (88.8) pikë.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit konstaton se Njoftimi për rezultatet përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve i datës 11.07.2023 është nxjerr në pajtim me nenin 25 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërsa procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtueshmëri me parimet e përgjithshme të pranimit të përcaktuara me nenin 6 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Andaj bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur

UJ
Këshilli i
Kamenicës
KOMUNA E KAMENICËS

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër **A.nr.958/2023**

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, Gëzim Zeqiri;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

